



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

RRUGA INTEGRUESE ROLI I NIVELIT LOKAL

Pasqyrimi për Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut

Prishtinë, 2023

Ky aktivitet realizohet në kuadrin e projektit 'Dialogue for European Municipalities' (DEM), i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë.



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Përmbledhja	4
Administrata Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve:.....	6
Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale.....	9
Barazia gjinore, jo-diskriminimi, përfshirja sociale dhe minoritetet:.....	12
Qeverisja e mirë, demokracia lokale, shoqëria civile dhe kundër korrupsioni	15

Hyrje

Raportet për vendet përkatëse të Komisionit Evropian (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut) shërbejnë si pikë reference për institucionet e Bashkimit Evropian (BE) lidhur me vlerësimin e progresit të shteteve të lartpërmendura përgjatë rrugëtimit në BE. Në periudhën krahasuese 2022, fushat e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut janë analizuar të grupuara në katër dimensione: 1) Administrata Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve; 2) Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale; 3) Barazia Gjinore; Jo-Diskriminimi, Përfshirja Sociale dhe Minoritetet; 4) Qeverisja e Mirë, Demokracia Lokale, Shoqëria Civile dhe Kundër Korrupsioni.

Në kontekstin e qeverisjes lokale janë ndërthurur të dhënat nga Raportet e Komisionit Evropian (KE) për vendet me objektivat e dokumenteve strategjike në fushat e analizuara/krahasuara. Në pjesën e përmbledhjes janë nxjerrë të dhëna nga përmbushja e obligimeve të shteteve përkatëse (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut) në përmbushjen e obligimeve nga procesi i integritimit, në fokus kritereve politike dhe ekonomike. Dokumenti ofron një pasqyrim të gjerë të sfidave, progresit dhe fokusit që duhet të mbajnë vendet në avancimin e politikave lokale karshi procesit integruar. Pavarësisht stadiut integruar, qeverisja lokale ka një rol të rëndësishëm në përshpejtimin e përafrimit të kritereve nga Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit.

Dokumenti është i shtrirë në tri aspekte kyçe: 1) Përshkrimi i të gjeturave nga raportet e Komisionit Evropian për Vendet; 2) Objektivat e vendosura në dokumentet strategjike në fushën e qeverisjes lokale dhe 3) Veprimet kyçe. Dokumenti vendos në pah të përbashkëtat, si dhe dallimet mes vendeve në këto aspekte. Ky dokument u shërben politik-bërësve, vendimmarrësve dhe aktorëve tjerë që angazhohen në fushën e qeverisjes lokale për të parë, krahasuar dallimet, por edhe të përbashkëtat që dalin si sfida rajonale në procesin e integritimit. Por, merr parasysh edhe rolin e rëndësishëm të qeverisjes lokale për arritjen e objektivave dhe ndërmarrjen e veprimeve.

Dokumenti ka për synim që të shtyjë vendet veç e veç në ndërmarrjen e veprimeve në përmbushjen e obligimeve, duke i krahasuar veprimet mes shteteve, të nxisë shkëmbimin e informacionit dhe praktikave në përmbushjen e këtyre obligimeve si dhe të shtojë partneritetet mes vendeve në përafrimin e proceseve integruar evropiane.

Rëndësia e dokumentit shtohet edhe në proceset planifikuese të dokumenteve strategjike kombëtare/nacionale për fushën e qeverisjes lokale, duke parë diferencat krahasuese mes vendeve, në veçanti në proceset e reformave, garantimin e barazisë gjinore, masat kundër korrupsionit, ngritjen e kapaciteteve njerëzore, për t'i shërbyer procesit të integritimit, si dhe sigurimin e përfshirjes sociale dhe të drejtave të minoriteteve.

Përmbledhja

KOSOVA

Kriteri Politik

Bazuar në të dhënat e ofruara nga komunat, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 64 % të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve politike. Një nga fushat kryesore që bënë pjesë në kuadër të kriterëve politike është funksionimi i administratës publike lokale. Në kuadër të kësaj fushe, komunat e Republikës së Kosovës kanë ndërmarrë aktivitete lidhur me sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për administratën lokale, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe ndërtimin e mekanizmave më efikas të llogaridhënies në raport me qytetarët. Në kuadër të masave për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, në 27 komuna është hartuar programi i trajnimeve, ndërsa në 6 komuna nuk është hartuar programi i trajnimeve për periudhën raportuese. Me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të kornizës së politikave në fushën e administratës, në pasqyrën e të dhënave të komunave mund të shohim se nga 33 komuna raportuese janë 13 komuna që është hartuar Strategjia për Komunikim me Publikun, ndërsa në 20 komuna ende nuk është hartuar.

Kriteri Ekonomik

Bazuar në të dhënat e ofruara nga komunat, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022 komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur t'i përmbushin përafërsisht 81% të aktiviteteve të planifikuara në fushën e kriterëve ekonomike. Për ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët është paraparë krijimi i qendrave për regjistrimin e bizneseve (one stop shop-et) të cilat lehtësojnë ofrimin e shërbimeve për biznese, përfshirë regjistrimet e tyre. Në 29 komuna janë funksionale, ndërsa 4 Komuna nuk janë themeluar. Sa i përket dëgjimeve publike për planifikimin e buxhetit, në 27 komuna janë mbajtur 266 dëgjime publike, ndërsa 5 komuna nuk kanë mbajtur asnjë dëgjim publik.

SHQIPËRIA

Kriteri Politik

Në aspektin e demokracisë, Këshilli Konsultativ ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Në aspektin e administratës publike ka pasur progres në lidhje me reformën në administratën publike. Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një sfidë e rëndësishme për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Sfidat kryesore janë të lidhura me: mungesën e kapaciteteve njerëzore; burimet financiare të pamjaftueshme; si dhe bashkëpunimi ndër-institucional i limituar. Për të drejtat e njeriut, progres i limituar është bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendorë mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Vetëm 40% e bashkive kanë përfituar trajnime në vitin 2021 për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

Kriteri Ekonomik

Theksi është vendosur tek ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale. Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore ka vijuar të jetë në vëmendjen e Bashkive përmes hartimit dhe miratimit të planeve vendore të zhvillimit. Progres është shënuar në përmirësimin e kuadrit strategjik dhe ligjor për nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) duke rritur kapacitetet teknologjike. Kapacitetet njerëzore dhe financiare të Bashkive për të mbështetur me aktivitete dhe financime direkte për krijimin e bizneseve të reja mbeten shumë të ulëta dhe të përqendruara te bashkitë e mëdha. Janë bërë përpjekje nga një pjesë e bashkive për të orientuar dhe këshilluar NVM-të mbi mundësitë dhe potencialet për zhvillim duke i orientuar drejt tregut.

MAQEDONIA E VERIUT

Kriteri politik

Vendi ka vendosur në vend strukturën ligjore për të siguruar barazi gjinore përmes miratimit të Ligjit për Mundësi të Barabarta për Femrat dhe Meshkujt dhe Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në përgjithësi, në administratën publike, femrat dhe meshkujt kanë përfaqësim të ngjashëm. Megjithatë, në nivelin lokal, ka një dominim të meshkujve në strukturat e qeverisjes. Përveç kësaj, Veprimi do të adresojë probleme akute për komunitetet lokale, të identifikuar në mënyrë pjesëmarrëse dhe të përfshirë. Pritet që Veprimi të promovojë dialogun e politikave lokale me pjesëmarrjen e shumë grupeve sociale dhe etnike, duke shprehur më mirë shqetësimet e minoriteteve dhe personave të ndjeshëm. Përpjekje të konsiderueshme janë dhe do t'i dedikohen qëllimit të informimit të rregullt dhe përfshirjes, kur të jetë e mundur, të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë, si dhe çdo institucioni/organizatë tjetër që ka lidhje me monitorimin e zbatimit të programit, rezultatet dhe arritjet e realizuara.

Kriteri ekonomik

Aksioni do të mbështesë projekte të administratave lokale që përfitojnë nga mbështetja e fortë lokale dhe adresojnë probleme lokale akute. Përmirësimet e synuara përfshijnë bashkëfinancimin dhe alokimin e buxhetit për kostot e mirëmbajtjes, të cilat janë elemente të forta të pronësisë dhe krijojnë perspektiva të mira të qëndrueshmërisë. Komunikimit dhe vizibilitetit do t'u jepen një rëndësi të lartë gjatë zbatimit të Veprimit me një fokus të veçantë në vëmendje të rritur ndaj mjedisit, burimeve më të mëdha për komunat dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në vend.

Administrata Publike dhe Ofrimi i Shërbimeve:

Pamja rajonale:

Përgjithësisht vendet e rajonit (Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria), kanë ndërmarrë reforma sa i përket administratës shtetërore. Raportet për Vendet të Komisionit Evropian, nxjerrin në pah ende mangësi në statet e reformave.

Në nivel të politikave strategjike, vendet, kanë planifikuar përmirësimin e kornizës/sipas standardeve për qeverisje të mirë; forcimin e kapaciteteve; përmirësimin e shërbimeve; rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit; digjitalizimin e shërbimeve dhe përmirësimin e shërbimeve për grupet e cënueshme.

- **Për Kosovën**, vlerësohet se ekziston një nivel i përgatitjes së reformës së administratës publike. Sa i përket nivelit lokal theksohet se pabarazitë ndërmjet komunave në performancën dhe ofrimin e shërbimeve vazhduan, kërkohet që Komunitat të bëjnë përpjekje për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** planifikohet krijimi i një kornize për qeverisje të mirë dhe administratë efikase; si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale për qëndrueshmëri të shërbimeve komunale.
- **Për Shqipërinë**, vlerësohet se numri i qendrave të shërbimeve të shpejta dhe shërbimeve elektronike, edhe në nivele të ndryshme të automatizimit, vazhdoi të rritej, dhe informacioni për qytetarët mbi shërbimet publike u bë më i arritshëm; Zhvendosja e shpejtë ka ngritur pyetje rreth cilësisë dhe arritshmërisë së shërbimit për qytetarët me aftësi digjitale të kufizuara.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** planifikohet ofrimi i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare; rritje të performancës në menaxhimin e burimeve njerëzore; digjitalizimin e shërbimeve dhe përmirësimi i infrastrukturës në ofrimin e shërbimeve.
- **Për Maqedoninë e Veriut**, theksohet se delegimi i autoritetit për vendimmarrje i menaxhimit i mesëm, si në nivelin qendror ashtu edhe lokal, ende është i kufizuar. Kërkohet përpjekje e mëtejshme për të zbatuar efikasitetin e llogaridhënies menaxheriale në gjithë administratën publike.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** planifikohet përmirësimi i shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale; Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i mbulimit të popullatës me shërbime komunale.

KOSOVA:

Problemi: Sipas raportit, ekziston një nivel i përgatitjes në fushën e reformës së administratës publike; Përderisa korniza legjislative për aspekte të ndryshme të RAP është pjesërisht e vendosur, progresi mungon sa i përket zbatimit; Zbatimi i pamjaftueshëm i Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (LOFASHAP) ka çuar në një nivel jo të kënaqshëm të përmirësimit të performancës dhe llogaridhënies së administratës; Sa i përket pushtetit vendor, pabarazitë ndërmjet komunave në performancën dhe ofrimin e shërbimeve vazhduan; Komunitat duhet të bëjnë përpjekje për të përmirësuar planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar.

SHQIPËRIA:

Problemet: Në vitin 2021, numri i qendrave të shërbimeve të shpejta dhe shërbimeve elektronike, edhe në nivele të ndryshme të automatizimit, vazhdoi të rritej, dhe informacioni për qytetarët mbi shërbimet publike u bë më i arritshëm; Zhvendosja e shpejtë ka ngritur pyetje rreth cilësisë dhe arritshmërisë së shërbimit për qytetarët me aftësi digjitale të kufizuara; Reforma në kujdesin shoqëror po përparon, por duhen përpjekje financiare dhe administrative për të forcuar kapacitetet në nivel lokal për shpërndarjen e shërbimeve dhe lidhjen me masat aktive të tregut të punës; Shqipëria duhet të përgatisë strategji të reja të administratës publike dhe menaxhimit financiar publik në përputhje me strategjitë sektoriale relevante, njëkohësisht të rishikojë efikasitetin e strukturave aktuale të monitorimit.

MAQEDONIA E VERIUT:

Problemet: Delegimi i autoritetit për vendimmarrje i menaxhimit të mesëm, si në nivelin qendror, ashtu edhe lokal, ende është i kufizuar; Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të zbatuar efikasitetin e llogaridhënies menaxheriale në të gjithë administratën publike; E drejta e qytetarëve për të pasur qasje në informacionin publik është garantuar me ligj; Korniza ligjore që mbulon të drejtën e qytetarëve për një administratë të mirë parashikon shqyrtimin administrativ dhe gjyqësor; Shumica e vendimeve vazhdojnë të bazohen në konsiderata procedurale dhe jo në meritë, e cila në kombinim me procedurat e gjata, e dobëson motivimin e qytetarëve për të kërkuar drejtësi administrative; Maqedonia e Veriut nuk ka bërë asnjë përpërim në thjeshtëzimin e procedurave administrative; Qeverisjet vendore dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të përmirësojnë bashkëpunimin me qendrat e punës sociale për të zhvilluar dhe mbështetur shërbime të reja komunitare në të gjithë vendin, duke përfshirë shërbime për mbështetjen e fëmijëve në rrezik, fëmijëve romë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara që janë viktimat e diskriminimit dhe ndarjes.

Fushat	Analiza	Kosovë	Shqipëri	Maqedoni e Veriut
Administrata Publike dhe ofrimi i shërbimeve	Objektivat	Objektiva Strategjike 2. Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale; Objektiva Strategjike 3. Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët.	Shtylla 2. Ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standardeve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; Shtylla 3. Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre.	Prioriteti 3.2. Përmirësimi i shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale; Prioriteti 4.2. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i mbulimit të popullatës me shërbime komunale; Për fushën e administratës nuk ka prioritete të përcaktuara.
	Veprimet kyçe	7.3.2. Fasilitimi i ndryshimit të sjelljes së punonjësve të administratës; 7.2.4. Krijimi i strukturave të qëndrueshme për të siguruar efikasitetin e administratës lokale; 7.2.5. Përdorimi i teknologjisë informative për të ofruar shërbimet on-line.	Objektivi specifik 2.2. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.	1.1.5. Planifikimi i një programi të përbashkët me pushtetin qendror dhe organet rregullatore për të subvencionuar llogaritë e përdoruesve të shërbimeve që i përkasin grupeve të cënueshme dhe që përdorin ndihmën dhe shërbimet sociale; 1.1.8. Integrimi i shërbimeve në lidhje me strehimin social në fushën e mbrojtjes sociale si një kompetencë lokale dhe sigurimi i financimit të qëndrueshëm në kombinim me transferime të caktuara të fondeve nga Buxheti Qendror; 1.1.4. NPK-të komunale për të përmirësuar ndjeshëm praktikën dhe sistemet e tyre të informacionit dhe menaxhimit.

Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale

Pamja rajonale:

Përgjithësisht sa u përket kapaciteteve të menaxhimit të burimeve njerëzore, në vendet e rajonit (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut), konstatohet nevoja për përmirësimin e planifikimit/ofrimit të shërbimeve. Ndërkaq, sa u përket financave lokale, kërkohet përmirësimi i financimit dhe ndarja e të ardhurave, si dhe transparenca buxhetore.

Në nivel të politikave strategjike vendet kanë planifikuar objektiva në: forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale; përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit; rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave; si dhe sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për të zbatuar të gjitha kompetencat e decentralizuara.

- **Për Kosovën**, theksohet se kapacitetet e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të përmirësohen; duhet përmirësuar planifikimi/ofrimi i shërbimeve. Autonomia fiskale dhe llogaridhënia komunale, gjithashtu mund të përmirësohen me rritjen e madhësisë së grantit të përgjithshëm ose me vënien në funksion të mekanizmave për ndarjen e të ardhurave.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** parashihet krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale; forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët.
- **Për Shqipërinë**, del në pah se, njësitë e qeverisjes vendore lokale (NVV-ja) ende mungojnë burime financiare dhe kapacitete administrative të mjaftueshme për të ushtruar me efikasitet fuqitë e tyre më të mëdha të hartimit të politikave; Situata financiare e komunave është bërë më e komplikuar nga tronditjet ekonomike, duke bërë që burimet e tyre të disponueshme të ulen edhe më shumë.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** parashihet, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët; digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre; rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta.
- **Për Maqedoninë e Veriut**, theksohet se Ministria e Financave vazhdoi përpjekjet për të përmirësuar transparencën e menaxhimit të financave publike; U hoq një mjet i ri i transparencës mbi borxhin publik dhe u publikuan raporte tremujore mbi ekzekutimin e buxhetit të qeverisë lokale.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** parashihet përmirësimi i kornizës normative dhe aspekte tjera funksionale të sistemit të vetëqeverisjes lokale; sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për të zbatuar të gjitha kompetencat e decentralizuara duke thelluar decentralizimin fiskal; përmirësimin e shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale.

KOSOVA:

Problemet: Kapacitetet e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet të përmirësohen; duhet përmirësuar planifikimi/ofrimi i shërbimeve, mbledhja e të dhënave dhe kujdesi i integruar; kërkohet miratimi i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, përfshirë grantin për shërbime sociale; Autonomia fiskale dhe llogaridhënia komunale gjithashtu mund të përmirësohen me rritjen e madhësisë së grantit të përgjithshëm ose me vënien në funksion të mekanizmave për ndarjen e të ardhurave.

SHQIPËRIA:

Problemet: Njësitë e qeverisjes vendore lokale (NVV-ja) ende mungojnë burime financiare dhe kapacitete administrative të mjaftueshëm për të ushtruar me efikasitet fuqitë e tyre më të mëdha të hartimit të politikave; Situata financiare e komunave është bërë më e komplikuar nga tronditjet ekonomike, duke bërë që burimet e tyre të disponueshme të ulen edhe më shumë; Zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil duhet të përmirësohet në nivel lokal. Kontratat e përkohshme të punësimit për pozicione të shërbimit civil, megjithëse duke u zvogëluar, vazhdojnë të jenë të shpeshta në NVV-të.

MAQEDONIA E VERIUT:

Problemet: Ministria e Financave vazhdoi përpjekjet për të përmirësuar transparencën e menaxhimit të financave publike; qeveria miratoi një program të ri të menaxhimit financiar publik për periudhën 2022-2025; U hoq një mjet i ri i transparencës mbi borxhin publik dhe u publikuan raporte tremujore mbi ekzekutimin e buxhetit të qeverisë lokale.

Fushat	Analiza	Kosovë	Shqipëri	Maqedoni e Veriut
Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale	Objektivat	7.2. Strategjitë e veprimit për arritjen e objektivit strategjik 2 - Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale; 7.3. Strategjitë e veprimit për arritjen e objektivit strategjik 3 Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave për të arritur përmirësim të qëndrueshëm në shërbimet komunale për qytetarët.	Objektivi strategjik 2. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët; Objektivi strategjik 3. Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre; Objektivi strategjik 4. Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta.	Prioriteti 1.1. Përmirësimi i kornizës normative dhe aspekte tjera funksionale të sistemit të vetëqeverisjes lokale; Prioriteti 1.2. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për të zbatuar të gjitha kompetencat e decentralizuara duke thelluar decentralizimin fiskal; Prioriteti 3.2. Përmirësimi i shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale.
	Veprimet kyçe	7.2.4. Krijimi i strukturave të qëndrueshme për të siguruar efikasitetin e administratës lokale; 7.2.5. Përdorimi i teknologjisë informative për të ofruar shërbimet online; 7.3.1. Qasja gjithëpërfshirëse dhe e koordinuar e zhvillimit të kapaciteteve profesionale; 7.3.2. Fasilitasi i ndryshimit të sjelljes së punonjësve të administratës.	Objektiv specifik 2.1. Konsolidim i rolit të NJVV në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare; Objektivi specifik 2.2. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike; Objektivi specifik 2.2. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike; Objektiv specifik 2.3. Përmirësim i efikasitetit të shërbimeve, në përputhje me standardet kombëtare e vendore. Objektiv specifik 2.4. Përmirësimi i performancës së qeverisjes vendore bazuar mbi një sistem nxitës të performancës, që shërben si një mekanizëm dialogu dhe llogaridhënieje ndaj komuniteteve vendore; Objektivi specifik 1. Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe me standarde.	1.1.7. Përmirësimi i shërbimeve lokale administrative përmes digjitalizimit, i ndjekur nga ndërtimi i kapaciteteve dhe standardeve të përshtatshme; 1.1.9. Transferimi i kompetencave të reja me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e tyre; 1.2.1. Thëllimi i decentralizimit fiskal duke rritur gradualisht të ardhurat komunale duke forcuar burimet e tyre të të ardhurave, duke rritur përpjekjet fiskale dhe transferime më të larta të buxhetit qendror; 1.2.2. Forcimi i kapacitetit të njësive të vetëqeverisjes lokale për administrim të suksesshëm dhe mbledhje të të ardhurave të tyre; 1.2.3. Përmirësimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit nga komunat në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i financave publike dhe të zvogëlohen rreziqet që lidhen me stabilitetin financiar të komunave, institucioneve lokale dhe ndërmarrjeve; 1.2.4. Zbatimi i qëndrueshëm i rregullave për transparencën fiskale, përfshirë raportimin në kohë dhe regjistrimin e detyrimeve, me këtë edhe forcimin e përgjegjësisë në dispozicion të fondeve publike.

Barazia gjinore, jo-diskriminimi, përfshirja sociale dhe minoritetet:

Pamja rajonale:

Në vlerësimin për vendet (Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni e Veriut), vendoset theksi se: gratë mbesin të nën-përfaqësuara në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes; Përfaqësimi i grave në pushtetin vendor vazhdon të kërkojë përmirësim; ende ka shumë mungesa dhe mos konsistenca në strukturën ligjore zgjedhore; Politikat dhe legjislacioni për të drejtat themelore kërkojnë përmirësim, duke përfshirë koordinimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe komuniteteve jo shumicë; Nevojiten përpjekje të thella për të adresuar diskriminimin dhe dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara; Përmirësime në Ligjin mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen Kundër Diskriminimit;

Në nivel të politikave strategjike, vendet nuk kanë vendosur objektiva specifike sa i përket barazisë gjinore, jo diskriminimit, përfshirjes sociale dhe minoriteteve. Po ashtu, nuk ka ndonjë qasje ndërthurëse sa u përket këtyre fushave/çështjeve. Problematikat vetëm përmenden në disa prej objektivave dhe veprimeve.

- **Për Kosovën** theksohet se, gratë mbesin të nën-përfaqësuara në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes; Politikat dhe legjislacioni për të drejtat themelore kërkojnë përmirësim, duke përfshirë koordinimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe komuniteteve jo shumicë;
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** nuk janë paraqitur objektiva specifike lidhur me barazinë gjinore, megjithatë përmendet në disa raste sikurse “mundësisë së thithjes së fondeve qeveritare sipas një sistemi gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminuese” si dhe “duhet të krijohen mekanizma institucionalë për investimet kapitale në komuna, të bazuar në parimin e mos diskriminimit”.
- **Për Shqipërinë** theksohet se, përfaqësimi i grave në pushtetin vendor vazhdon të kërkojë përmirësim; Nevojitet zbatim më i mirë dhe ngritje e ndërgjegjësimit për të eliminuar fjalët e urrejtjes, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta; kërkohen përpjekje dhe resurse të shtuara për të përmirësuar përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve dhe mbrojtjen për personat me aftësi të kufizuara.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** nuk ka objektiva të cilat adresojnë diskriminim dhe përfshirjen e minoriteteve; gjithashtu nuk ka objektiva lidhur me barazinë gjinore, por theksohet se nevojitet krijimi i një njësie të posaçme, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor.
- **Për Maqedoninë e Veriut** theksohet se, zgjedhjet ishin konkurruese dhe liritë themelore u respektuan gjerësisht, por ende ka shumë mungesa dhe mos konsistenca në strukturën ligjore zgjedhore; ndryshimet e shpeshta dhe shpeshherë të pakoordinuara në Kodin Zgjedhor, të miratuara në mënyrë të ngutshme dhe vetëm para zgjedhjeve, janë kundër praktikave ndërkombëtare të mira; Kandidatët mundën të kandidonin lirisht, por shpeshherë ekzistonte një retorikë negative kundër grave; komisioni sugjeroi përmirësime në Ligjin mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen Kundër Diskriminimit;
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** synohet përmirësimi i shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe zhvillimi i njësisive të vetëqeverisjes lokale përmes kulturës.

KOSOVA:

Problemet: Zgjedhjet lokale të vitit 2021 kanë qenë mirë të administruara, transparente, si dhe konkurruese, me përjashtim të zonave me shumicë serbe; Gratë mbesin të nën-përfaqësuara në të gjitha nivelet e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes; Pak parti politike e kanë tejkaluar kuotën gjinore prej 30% dhe për këtë arsye nuk kanë arritur objektivin prej 50% për përfaqësim të paraparë në Ligjin për Barazi Gjinore; Politikat dhe legjislacioni për të drejtat themelore kërkojnë përmirësim, duke përfshirë koordinimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe komuniteteve jo shumicë; Një koordinim dhe komunikim institucional ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes do të përmirësonte efektivitetin e mekanizmave dhe strukturave të nivelit qendror dhe lokal, si dhe kornizave adekuate ligjore për mbrojtjen e minoriteteve.

SHQIPËRIA:

Problemet: Përfaqësimi i grave në pushtetin vendor vazhdon të kërkojë përmirësim; Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të forcuar zbatimin, duke përfshirë ofrimin e trajnimit të specializuar për gjykatës dhe prokurorët; Nevojitet zbatim më i mirë dhe ngritje e ndërgjegjësimit për të eliminuar fjalët e urrejtjes, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta; Ende nevojiten përpjekje për ndërgjegjësimin dhe forcimin e kapaciteteve të zyrtarët e drejtësisë penale për krimet e urrejtjes; Nevojiten përpjekje të thella për të adresuar diskriminimin dhe dhunën ndaj personave me aftësi të kufizuara, për të përmirësuar qasjen në përgjithësi, për të promovuar punësimin dhe për të mbledhur të dhëna statistikore mbi situatën e tyre; Nevojiten përpjekje dhe resurse të shtuara për të përmirësuar përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve.

MAQEDONIA E VERIUT:

Problemet: Zgjedhjet vendore u zhvilluan më 17 dhe 31 tetor 2021 dhe vetëm dy gra u zgjedhën si kryetare bashkie; Zgjedhjet ishin konkurruese dhe liritë themelore u respektuan gjerësisht, por ende ka shumë mungesa dhe mos konsistenca në strukturën ligjore zgjedhore; Ndryshimet e shpeshta dhe shpeshherë të pakoordinuara në Kodin Zgjedhor, të miratuara në mënyrë të ngutshme dhe vetëm para zgjedhjeve, janë kundër praktikave ndërkombëtare të mira; Kandidatët mundën të kandidonin lirisht, por shpeshherë ekzistonte një retorikë negative kundër grave; U konfirmua diskriminimi në 60% të rasteve të ngritura kundër sektorit publik; Komisioni sugjeroi përmirësime në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen Kundër Diskriminimit; Departamenti i Ombudspersonit (avokati i popullit) për mbrojtjen kundër diskriminimit vazhdon të ketë mungesë të personelit; Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të bërë sistemin e mbrojtjes sociale më ndjeshëm ndaj fëmijëve.

Fushat	Analiza	Kosovë	Shqipëri	Maqedoni e Veriut
Barazia gjinore, diskriminimi dhe përfshirja sociale e minoritetet:	Objektivat	Nuk ka paraqitur objektiva që kanë të bëjnë me barazinë gjinore; Po ashtu, nuk ka asnjë objektivë lidhur me barazinë gjinore, megjithatë përmendet në disa raste si: tek Objektiva strategjike 1. “mundësisë së thithjes së fondeve qeveritare sipas një sistemi gjithëpërfshirës dhe jo-diskriminues” dhe tek pjesa e rekomandimeve “Duhet të krijohen mekanizma institucionalë për investimet kapitale në komuna, të bazuar në parimin e mos-diskriminimit”; Objektivi strategjik 4. Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive.	Për diskriminim dhe përfshirjen e minoriteteve nuk ka objektiva dhe nuk përmenden. Barazia gjinore është përmendur tek nëntitulli “Strukturat institucionale dhe burimet njerëzore” si në vijim: “Për më tepër, ligji nr. 139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’, përcakton edhe krijimin e njësive të menaxhimit të performancës në çdo bashki (Neni 33 “njësia vendore do të jetë përgjegjëse për krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor”). Barazia gjinore është përmendur edhe tek nëntitulli “Të ardhura nga aktiviteti ekonomik i njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet përdorimit me efikasitet të aseteve vendore” si në vijim: “Njësitë e vetëqeverisjes kanë funksione të qarta në fushën e zhvillimit ekonomik vendor që përfshijnë f) Dhënien e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.”	Prioriteti 3.2. Përmirësimi i shërbimeve lokale në lidhje me mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale; Maqedonia e Veriut nuk ka objektiva specifike sa i përket diskriminimit dhe as nuk ka asnjë theks; Prioriteti 3.3. Zhvillimi i njësive të vetëqeverisjes lokale përmes kulturës.
	Veprimet kyçe	Nuk ka paraqitur veprime kyçe që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, dhe diskriminimin. 7.5.2. Promovimi i diversitetit etnik dhe gjuhësor.	Nuk ka paraqitur veprime kyçe që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, diskriminimin apo përfshirjen sociale të minoriteteve.	1.1.13. Zbatimi i plotë i Ligjit të ri për mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat me fokus në masat dhe aktivitetet për të promovuar barazinë gjinore në të gjitha programet horizontale të komunave; 1.1.3. Përgatitja dhe zbatimi i programeve për promovimin e vlerave kulturore të të gjitha bashkësive etnike si dhe programeve për mbështetjen e aktiviteteve për të rinjtë, gratë dhe grupet e rrezikuara të popullatës; Maqedonia e Veriut nuk ka objektiva specifike sa i përket diskriminimit dhe as nuk ka asnjë theks; Po ashtu, nuk ka asnjë objektivë dhe asnjë theks sa i përket minoriteteve.

Qeverisja e mirë, demokracia lokale, shoqëria civile dhe kundër korrupsioni

Pamja rajonale:

- **Për Kosovën** theksohet se është arritur progres i kufizuar lidhur me zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023; Bashkëpunimi me qeverinë duhet të përmirësohet më tej përmes një niveli më të lartë të angazhimit dhe transparencës; Në periudhën raportuese, është arritur njëfarë progresi me miratimin e legjislacionit të rëndësishëm kundër korrupsionit; Ekziston nevojë e vazhdueshme për të promovuar elaborimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës, përfshirë edhe në nivel komunal; Kuvendet Komunale nuk luajnë rol mbikëqyrës mbi ekzekutivin komunal.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** synohet krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale; Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve; Nuk ka ndonjë objektivë strategjike sa i përket demokracisë lokale, por ka theks tek përmbledhja ekzekutive; Po ashtu, nuk ka ndonjë objektivë apo theks lidhur me anti-korrupsionin.
- **Për Shqipërinë** theksohet se nuk ka pasur përparim në zbatimin e planit të veprimit për një mjedis të mundësuar për shoqërinë civile; Vazhdon të jetë në varësi të fortë nga mbështetja nga donatorët; Zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil duhet të përmirësohet në nivel lokal; Në lidhje me transparencën, u vërejt një përmirësim, pasi të gjitha komunat tani publikojnë në internet vendimet e Këshillit të tyre.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** synohet përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor si dhe Forcimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor; nuk ka objektiv strategjik për shoqërinë civile.
- **Për Maqedoninë e Veriut** theksohet se vendi ka nevojë të përfundojë procesin e reformës së sistemit të vetëqeverisjes vendore; u zhvilluan fushata publike për ngritjen e ndërgjegjësimit për integritetin, mbrojtjen e denoncuesve, dhe më gjerësisht për luftën kundër korrupsionit; nevojiten përpjekje për të përmirësuar transparencën në hartimin e politikave dhe përfshirjen e proceseve konsultuese; Zhvillimi profesional nuk është i sistematizuar dhe qeverisë ende i mungon një bazë e qëndrueshme të të dhënave për të gjitha trajnimet e ofruara nga institucione të ndryshme.
 - **Ndërlidhur me politikat strategjike:** synohet përmirësimi i kornizës normative dhe aspekte tjera funksionale të sistemit të vetëqeverisjes lokale si dhe zbatimi i qëndrueshëm i parimeve të qeverisjes së mirë (gjithpërfshirja, transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja) në nivelin lokal; Sa i përket shoqërisë civile, nuk ka ndonjë objektivë specifike e asnjë theks.

KOSOVA

Problemet: Është arritur progres i kufizuar lidhur me zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023; Bashkëpunimi me qeverinë duhet të përmirësohet më tej përmes një niveli më të lartë të angazhimit dhe transparencës; Nuk u vu re asnjë progres në lidhje me zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit të vitit 2019, që do të lehtësonte procesin e regjistrimit të organizatave; Kosova është në fazën e hershme/ka njëfarë niveli të përgatitjes. Në periudhën raportuese, është arritur njëfarë progresi me miratimin e legjislacionit të rëndësishëm kundër korrupsionit; Kosova, në veçanti duhet: të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për të siguruar që ajo mund të ushtrojë në mënyrë efektive mandatin e saj; të forcojë më tej bashkëpunimin mes organeve të zbatimit të ligjit dhe Prokurorisë dhe të inkurajojë bashkëpunimin multidisiplinar dhe qasjen e bazuar në objektiv për të siguruar hetime pro-aktive dhe për të luftuar në mënyrë efektive rastet e korrupsionit të nivelit të lartë; Ekziston nevojë e vazhdueshme për të promovuar elaborimin dhe miratimin e planeve të integritetit në shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës, përfshirë edhe në nivel komunal; Kuvendet Komunale nuk luajnë rol mbikëqyrës mbi ekzekutivin komunal.

SHQIPËRIA

Problemi: Nuk ka pasur përparim në zbatimin e planit të veprimit për një mjedis të mundësuar për shoqërinë civile; Vazhdon të jetë në varësi të fortë nga mbështetja nga donatorët; Aftësia e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për të shprehur prioritetet e organizatave joqeveritare në proceset e hartimit të politikave mbetet e dobët; Zbatimi i Ligjit të Shërbimit Civil duhet të përmirësohet në nivel lokal; Kontratat e përkohshme të punësimit për pozicione të shërbimit civil, megjithëse duke u zvogëluar, vazhdojnë të jenë të shpeshta në NVV-të; Në lidhje me transparencën, u vërejt një përmirësim, pasi të gjitha komunat tani publikojnë në internet vendimet e Këshillit të tyre.

MAQEDONIA E VERIUT

Problemet: Vendi ka nevojë të përfundojë procesin e reformës së sistemit të vetëqeverisjes vendore; SCPC miratoi një politikë integriteti me udhëzime për organet shtetërore dhe institucionet e sektorit publik, si dhe udhëzime për vetëqeverisjen lokale; Në qershor 2022, 66 komuna, 15 organe shtetërore dhe institucione të sektorit publik, duke përfshirë Ministrinë e Brendshme, kanë adoptuar gjithashtu një politikë integriteti. U zhvilluan fushata publike për ngritjen e ndërgjegjësimit për integritetin, mbrojtjen e denoncuesve, dhe më gjerësisht për luftën kundër korrupsionit; Shoqëria civile vazhdoi të luajë një rol të rëndësishëm në proceset e marrëveshjeve dhe në monitorimin e aktiviteteve të shtetit. Megjithatë, nevojiten përpjekje për të përmirësuar transparencën në hartimin e politikave dhe përfshirjen e proceseve konsultuese; Zhvillimi profesional nuk është i sistematizuar dhe në qeveri ende mungon një bazë e qëndrueshme të të dhënave për të gjitha trajnimet e ofruara nga institucione të ndryshme. Ajo ka përmirësuar rregulloret mbi integritetin në shërbimin publik në nivelin qendror dhe lokal dhe ka miratuar një metodologji për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit institucional në nëntor 2021; Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është duke punuar për të forcuar integritetin profesional në komunat.

Fushat	Analiza	Kosovë	Shqipëri	Maqedoni e Veriut
Qeverisja e mirë, demokracia lokale, shoqëria civile dhe kundër-korrupsioni	Objektivat	Objektiva Strategjike 2. Krijimi i një kornize për qeverisje të mirë për të siguruar përfaqësimin demokratik të qytetarëve dhe administratë efikase komunale; Objektiva Strategjike 4. Forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive; Nuk ka ndonjë objektivë strategjike sa i përket demokracisë lokale, por ka theks tek përmbledhja ekzekutive “Përmes Strategjisë së Vetëqeverisjes Lokale do të promovohet vetëqeverisja lokale dhe demokracia lokale, në mënyrë që sistemi i vetëqeverisjes lokale të përmbushë qëllimin e tij për të përballuar sfidat ekonomike, sociale dhe politike”; Po ashtu, nuk ka ndonjë objektivë apo theks lidhur me anti-korrupsionin.	Nuk ka objektiv strategjik për shoqërinë civile. Objektivi strategjik 5. Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor. Shtylla 5. Forcimi i demokracisë vendore dhe avancim i agjendës së integritetit evropian në nivel vendor.	Prioriteti 1.1. Përmirësimi i kornizës normative dhe aspekte tjera funksionale të sistemit të vetëqeverisjes lokale. Qëllimi specifik 6. Zbatimi i qëndrueshëm i parimeve të qeverisjes së mirë (gjithëpërfshirja, transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja) në nivelin lokal; Sa i përket shoqërisë civile, nuk ka ndonjë objektivë specifike e asnjë theks.
	Veprimet kyçe	7.2.1. Krijimi i bazës ligjore për një qeverisje efektive komunale duke marrë në konsideratë parimet e qeverisjes së mirë; 7.4.4. Rritja e partneritetit ndërmjet sektorit publik dhe privat përmes fuqizimit të i shoqërisë civile dhe bizneseve të reja; Kosova nuk ka ndonjë veprim kyç lidhur me demokracinë lokale dhe anti-korrupsionin.	Nuk ka objektiv specifik për shoqërinë civile. Objektivi specifik 5.1. Forcimi i demokracisë vendore nëpërmjet sigurimit të një qasje gjithëpërfshirëse të mirëqeverisjes në nivel vendor; Objektivi specifik 5.2. Nxitja e politikave kundër korrupsionit në nivel vendor dhe konsolidimi i mëtejshëm i arritjeve mbi integritetin.	1.1.2. Përmirësimi i të gjitha aspekteve të qeverisjes së mirë lokale me një fokus në promovimin e transparencës lokale, qasjen në informacion, gjithëpërfshirjen dhe llogaridhënien; 1.1.10. Përmirësimi i mëtejshëm i politikave lokale për të siguruar integritet dhe për të menaxhuar rreziqet e korrupsionit.



**KOSOVO LOCAL
GOVERNMENT
INSTITUTE**

Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com